



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 11011 Prot

Lezhë, më 13 / 07 /2020

VENDIM

Nr. 104 datë 10 . 07 .2020

“PËR

**MIRATIMIN E LISTAVE TË PËRFITUESVE PËR GRANTE RIKONSTRUKSIONI
PËR SHTËPITË INDIVIDUALE DHE BANESA NË NDËRTESEA (PALLATE) ME
SHKALLË DËMTIMI DS1, DS2, DS3”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 3, pika 23, nenit 7, pika 1, nenit 30, nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë dhe Lezhë”, i ndryshuar, Aktit normativ nr.9 datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimin nr.904 datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimit nr.5 datë 06.01.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projekti model”, VKB nr.76, datë 09.06.2020 “Për miratimin e masës së grantit të rikonstruksionit ose riparimit për nivelin e dëmit DS1, DS2, DS3, për banesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 në Bashkinë Lezhë”, VKB nr.79, datë 25.06.2020 “Për miratimin e vërtetimit të lëshuar nga Kryetari i Fshatit dhe Administratori i Njësisë Administrative, si dhe dokumentacionit tjetër plotësues, që vërtetojnë posedimin dhe gëzimin e vazhduar të banesave, si dhe vërtetimit të legalizimit dhe formularit të aplikimit, si dokumentacion që provojnë pronësinë e objektit për aplikuesit për programin e rindërtimit”, VKB nr.80, datë 25.06.2020 “Për miratimin e udhëzuesit “Për detajimin e procedurave për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit”, dhe kontratës tip për të përfituar nga grantet e rikonstruksionit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së përfituesve, (subjekteve që plotësojnë kriteret për përfitim) nga

programi i granteve të rindërtimit (granti i rikonstruksionit), sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Juridike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI

ERNEST RAKAJ

